



E lajmërojnë për kanosje, policia përveç armës i gjen edhe marihuanë



LAJME

06/09/2023 22:13



Policia e Kosovës, përkatësisht ajo e rajonit të Gjakovës kanë arrestuar dy të dyshuar, fillimisht për kanosje.

Pas kontrollës, tek ata u gjet edhe një substancë që sipas autoriteteve është e llojit marihuanë, përcjell **lajmi.net**.

Kështu bëri të ditur policia përmes një komunikate të para pak çasteve dërguar medieve.

“Me datën 06.09.2023, njësitet patrulluese në kuadër të Stacionit Policor në Gjakovë ju kanë përgjigjur një rasti kanosje të raportuar në rrugën “Sylejman Hadum Aga” në Gjakovë. Zyrtarë Policorë në kuadër të këtij stacioni, kanë arritur të identifikojnë dhe të arrestojnë dy të dyshuar, meshkuj kosovarë të moshës madhore.

Tek njëri nga të dyshuarit janë gjetur dhe konfiskuar dy pistoleta të cilat dyshohet se janë përdorur në rast. Po ashtu tek i njëjti është gjetur dhe konfiskuar një sasi e dyshuar narkotike e llojit marihuan.Me vendim të Prokurorit të Shtetit (në koordinim me të cilin janë ndërmarr të gjitha veprimet hetimore) njëri nga të dyshuarit është ndalur në mbajtje për 48 orë”.

Artikuj të ngjashëm



September 7, 2023

Drejtori i Prokurimit në Zyrën e Kryeministrit me aktakuzë për fshehje...



September 7, 2023

Avokati i Kadri Veselit në Speciale: Raportet e dëshmitarit të prokurorisë...



September 7, 2023

Ministria Drejtsisë me forcë policore tentoi të ia marrë lëndët: Flet...



September 7, 2023

Harroni qeset e plastikës, finalizohet Udhëzimi Administrativ që ndalon përdorimin e...



September 7, 2023

Gara me Biçikleta: Mbyllen autostradat dhe disa rrugë



September 7, 2023

Osmani: Kushtetuta e Kaçanikut simbolizon përkushtimin tonë dhe guximin e delegatëve...

LAJME TË FUNDIT



Drejtori i Prokurimit në Zyrën e Kryeministrit me...



Ministria Drejtsisë me forcë policore tentoi të ia...



“Të dy ndryshuam historinë e futbollit dhe respektojmë...



Të dashurën 54 vjet më të re, Al...